

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Alta Platform Holdings Limited, me seli të regjistruar në nivel 1, Qendra e Biznesit Phoenix, Trick Il - Ferovia (Hekurudha e Vjetër), Santa Venera, SVR 9022, Maltë, përmes Shoqërisë së Avokatëve Qoku & Partnerëve nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 10.06.2026, miratoi këtë

### AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi, me të cilin Alta Platform Holdings Limited, me seli të regjistruar në nivel 1, Qendra e Biznesit Phoenix, Trick Il - Ferovia (Hekurudha e Vjetër), Santa Venera, SVR 9022, Maltë, do të fitojë kontroll mbi Rhino Services Limited SHPKNJP Manastir, me seli të regjistruar në rr. „Mitropolitska“ nr. 13b, Manastir, Maqedonia e Veriut, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 denarë, si dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra dhe programi i të hyrave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

### Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 13.05.2026 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga Alta Platform Holdings Limited, me seli të regjistruar në nivel 1, Qendra e Biznesit Phoenix, Trick Il - Ferovia (Hekurudha e Vjetër), Santa Venera, SVR 9022, Maltë, me të cilin Alta Platform Holdings Limited do të fitojë kontroll mbi Rhino Services Limited SHPKNJP Manastir, me seli të regjistruar në rr. „Mitropolitska“ nr. 13b, Manastir, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimin të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe bashkëngjitjeve të tij, konstatoi si vijon:

## **Veprimtaritë kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:**

Alta Platform Holdings Limited është një shoqëri e themeluar në Maltë, veprimtaritë kryesore të së cilës përfshijnë posedimin, fitimin, administrimin dhe disponimin me aksione, investime dhe/ose letra me vlerë. Alta zotëron tërësisht kapitalin themeltar të emetuar të Alta Platform Gaming Limited, me seli të regjistruar në nivel 1, Qendra e Biznesit Phoenix, Trick Il - Ferovia (Hekurudha e Vjetër), Santa Venera, SVR 9022, Maltë veprimtaria kryesore e së cilës është ofrimi i lojërave të kazinosë, basteve sportive (përfshirë bastet e drejtpërdrejta) dhe shërbimeve peer-to-peer poker për konsumatorët përfundimtarë përmes disa platformave online të markave të njohura.

Alta Platform Gaming Limited është operator i licencuar për lojëra të fatit online, i rregulluar nga Autoriteti i Lojërave të Fatit të Maltës.

Alta Platform Holdings Limited dhe Alta Platform Gaming Limited janë pjesë e Alta Group, e cila është në pronësi të plotë të z. Lorang Volmar Anders Andreassen, i cili zotëron 100% të APHL Limited, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Maltë, e cila nga ana e saj zotëron 100% të pjesëve në Alta Platform Holdings Limited.

Alta Platform Holdings Limited zotëron 100% edhe të dy shoqërive të tjera të varura (krahas Alta Platform Gaming Limited): Alta Platform Services Limited dhe 3P Solutions Ltd, që do të thotë se z. Andreassen ushtron kontroll të vetëm dhe përfundimtar mbi të gjithë grupin.

Alta Platform Holdings Limited nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ushtron asnjë veprimtari afariste në tregun maqedonas.

Rhino Services Limited SHPKNJP është një shoqëri maqedonase që shërben si qendër për teknologji, zhvillim të produkteve, mbështetje të klientëve dhe burime njerëzore për grupin e shoqërive Rhino Entertainment Group, pjesë e të cilit është.

Rhino Entertainment Group ushtron veprimtari afariste në fushën e lojërave online, XXX<sup>1</sup>, të cilat realizohen në përputhje me licencat përkatëse për organizimin e lojërave të fatit.

Rhino Services nuk ka shoqëri të varur të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë vendit.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

---

<sup>1</sup> Të dhënat janë sekret tregtar.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

**Udhëzim për mjetin juridik:**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**

**KRYETARE**

**Mr. Малинка Силјановска Николиќ**